



LISTA KONTROLLUESE E PUNËDHËNËSIT PËR VETËVLERËSIM

PJESA 2:	RREZIQET NË PUNË
Tema 2.5.	AGJENTËT BIOLOGJIKË
Nën-tema 2.5.2.	LËNDIMET E MPREHTA NË SEKTORIN E KUJDESIT SHËNDETËSOR
Ligji / rregulloret përkatëse:	• Rregullore (MPMS) Nr.03/2017 për parandalimin e lëndimeve nga mjetet e mprehta në vendin e punës pranë sektorit të kujdesit shëndetësor dhe spitalor; • Rregullore (MPMS) Nr.05/2017 për mbrojtjen e të punësuarve nga risqet që lidhen me agjentët biologjikë në punë.
Shkurtesa:	• PPM – Pajisje Personale Mbrojtëse • MPMS – Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Përdorimi i listës kontrolluese:	Nëse përgjigjeni “Po” në një pyetje, ju lutemi kaloni në pyetjen tjetër, në rast se përgjigjeni “Jo” bëni vërejtje se mund të planifikoni të ndërmerren veprime për të përmbushur kërkesat ligjore.

Nr.	Pika kontrolli	Po	Jo	Vërejtje për zbatimin
	PARA VIZITËS NË LOKACION / VENDET E PUNES			
	* <i>Përgatituni për vizitën në lokacion. Nëse nuk i mbani mend kërkesat tuaja të brendshme, udhëzimet për punën me agjentët biologjikë dhe lëndimet me mjetet e mprehta, lexojini përsëri dokumentet për të qenë gati për vizitën në lokacion.</i>			
	INSPEKTIMI I LOKACIONIT / VENDEVE TË PUNËS			
	* <i>Gjatë vizitës në lokacion / vendin e punës kushtojini vëmendje aktiviteteve që ndodhin.</i> * <i>Lëndimet me gjilpëra dhe lëndimet e tjera të mprehta janë një rrezik serioz në çdo mjedis të kujdesit shëndetësor.</i> * <i>Kontakti me gjilpëra, bisturi, qelq të thyer dhe mjete të tjera të mprehta të kontaminuara mund t'i ekspozojë punëtorët e kujdesit shëndetësor ndaj gjakut që përmban patogjenë që paraqesin rrezik të madh.</i>			

	* Vëzhgoni procesin e asgjësimit të mbeturinave dhe sigurohuni që ndiqen procedurat standarde të operimit, përfshirë përdorimin e enëve të etiketuara qartë dhe dukshëm. * Kontrolloni nëse të punësuarit: ▪ përdorin PPM të përshtatshme; ▪ janë pajisur me veshje të përshtatshme speciale; ▪ janë pajisur me vende ruajtje të ndara për veshjet e punës ose mbrojtëse dhe veshjet normale. * Jepni shembullin tuaj, përdorni PPM-të në varësi të agjentëve biologjikë dhe rreziqeve që ekzistojnë në lokacion / vendet e punës! * Mbani shënime për vendet e vëzhguara të punës dhe bëni fotografi. Kushtojini vëmendje shembujve të mirë dhe jo të mirë. * Bisedoni me të punësuarit, tregohuni miqësorë, shpjegoni dhe këshillojini ata për rregullat e përgjithshme të sigurisë në punë me gjilpëra, bisturi, qelq të thyer dhe pajisje të tjera të mprehta. * Përfundoni inspektimin duke ofruar një listë të mangësive dhe planet për përmirësim.			
1.	A janë të punësuarit potencialisht të ekspozuar ndaj agjentëve infektues në lëngjet e trupit? Rregullore (MPMS) Nr.03/2017, Neni 5.2 * Nëse të punësuarit punojnë ose kanë kontakte të drejtpërdrejta me njerëz ose lëngje të trupit njerëzor, ata mund të jenë në rrezik ndaj agjentëve biologjikë.			
2.	Programi i trajnimit dhe informacionit duhet të sigurohet për të punësuarit potencialisht në rrezik ndaj lëndimeve të mprehta. Rregullore (MPMS) Nr.03/2017, Neni 6, 7, 8 * Pyetni të gjithë të punësuarit a i dinë procedurat për përdorimin dhe asgjësimin e instrumenteve të mprehta mjekësore, a dinë çfarë të bëjnë me mbeturinat e kontaminuara etj. * A i dinë rreziqet e mundshme shëndetësore nga trajtimi i pasigurt i paraqitur nga gjaku i infektuar dhe nga lëngjet e tjera trupore?			

	<i>* Ju si punëdhënës jeni përgjegjës për të siguruar trajnime për punë të sigurt me instrumente të mprehta mjekësore, përdorimin e PPM-ve, procesin e dezinfektimit, etj. Mbani shënime për trajnimet.</i>			
3.	A asgjësohet materiali i mbeturinave në përputhje me masat speciale? A asgjësohet materiali i mbeturinave në mënyrë të sigurt? A është lehtësisht i qasshëm material i mbeturinave? Rregullore (MPMS) Nr.03/2017, Neni 6.1.1 <i>* Pyesni të gjithë të punësuarit a kanë njohuri për procedurat (a i dinë) e menaxhimit të mbeturinave.</i> <i>* Materialet e mbeturinave duhet të mbliidhen dhe të asgjësohen në mënyrë të sigurt dhe që të mos mund të qasen me lehtësi (të parandalohet qasja e publikut).</i> <i>* Kontrolloni nëse ofrohet grumbullimi dhe asgjësimi i mbeturinave speciale (p.sh. enë speciale për gjilpëra dhe mjete të mprehta).</i>			
4.	A pastrohen rregullisht sipërfaqet e vendit të punës edhe me dezinfektues? Rregullore (MPMS) Nr.03/2017, Neni 6.2.2 <i>* Mbani shënime për aktivitetet e pastrimit. Bëni një plan pastrimi nëse nuk e keni.</i>			
5.	A janë të disponueshme të gjitha pjesët e kërkuara të pajisjeve personale mbrojtëse, përfshirë përparëset sterile, dorezat e përshtatshme, kostumet e pastrimit, maskat kirurgjikale, kapelat dhe pelerinat? A i mbajnë të punësuarit pajisjet mbrojtëse kur largohen nga vendi i punës? Rregullore (MPMS) Nr.03/2017, Neni 6.2.3 <i>* Sigurohuni që pajisjet mbrojtëse të ruhen aty ku nuk mund të kontaminohen nga substancat e rrezikshme biologjike dhe ku nuk do të kontaminojnë veshjet personale.</i> <i>* Sigurohuni që PPM-të nuk përdoret jashtë vendit të punës.</i> <i>* Kostot financiare të PPM-ve duhet të mbulohen nga punëdhënësi (ju).</i>			

6.	Të punësuarit duhet të jenë të informuar/trajnuar pse duhet t'i përdorin PPM-të. Rregullore (MPMS) Nr.05/2017, Neni 10.1.4 <i>* Pyesni të punësuarit se cilat PPM duhet të përdorin dhe pse (p.sh. kur dhe pse duhet të përdorin dorëza, ose maskë fytyre, çfarë dorezash do të përdorin, ku janë këto dorëza). Trajtoni sërish të punësuarit nëse njohuritë e tyre kanë mangësi serioze.</i>			
7.	A e njohin të punësuarit simbolin e bio-rrezikut? Rregullore (MPMS) Nr.05/2017, Shtojca II, Neni 7.2.5  Rrezik biologjik			
8.	A janë shënuar dhe të disponueshme objektet e ndihmës së parë? Rregullore (MPMS) Nr.03/2017, Neni 6 <i>* Kontrolloni nëse mund t'i shihni shenjat e sigurisë për objektet e ndihmës së parë nga disa pika të lokacionit. Nëse nuk mund t'i shihni shenjat, pyesni të punësuarit se ku ndodhen objektet e ndihmës së parë. Vendosni ose rivendosni shenjat.</i>			
INSPEKTIMI I DOKUMENTEVE NË ZYRË				
	<i>* Takohuni me përfaqësuesit e menaxhmentit (nëse është e mundur) dhe/ose ekspertët për SSHP.</i> <i>* Shpjegoni vëzhgimet tuaja të mira dhe jo të mira nga vizita juaj në lokacion.</i> <i>* Në rastet e mangësive të vëzhguara, sqaroni situatën (psh. të punësuarit nuk përdorin PPM, etj.), gjeni shkakun dhe bëni plane për përmirësime të situatës.</i>			

	<i>* Tregohuni miqësorë, sqaroni dhe këshillojini për detyrimet e tyre në lidhje me trajtimin e sigurt të kimikateve, jepni shembuj të mirë nëse është e mundur.</i>			
9.	Sigurohuni që trajnimi për masat paraprake universale, trajnimi për pajisje/veshje personale mbrojtëse, është bërë dhe të ruhen shënimet. A i përfshijnë shënimet e trajnimit efektet shëndetësore, kontrollet, metodat e sigurta të punës etj.? Rregullore (MPMS) Nr.03/2017, Nenet 6.2, 8 <i>Sigurohuni që të punësuarit janë trajnuar dhe udhëzimet e sigurisë përfshijnë:</i> <i>* përdorimin e saktë të pajisjeve mjekësore që përfshijnë mekanizmat e mbrojtjes nga mjete të mprehta;</i> <i>* induksionin për të gjithë stafin e ri dhe të përkohshëm;</i> <i>* rrezikun lidhur me ekspozimin ndaj gjakut dhe lëngjeve trupore;</i> <i>* masat parandaluese përfshirë masat paraprake standarde, sistemet e punës së sigurt, procedurat e sakta të përdorimit dhe asgjësimit, rëndësinë e imunizimit, sipas procedurave në vendin e punës;</i> <i>* procedurat e raportimit, reagimit dhe monitorimit dhe rëndësinë e tyre;</i> <i>* masat që duhen ndërmarrë në rast të lëndimeve.</i>			
10.	A janë marrë masa për të zvogëluar dhe parandaluar rreziqet e lëndimeve? Rregullore (MPMS) Nr.03/2017, Nenet 5, 7 <i>Kontrolloni dokumentin e vlerësimit të riskut për të identifikuar nëse janë vlerësuar masa të tjera parandaluese, diskutoni me ekspertin për SSHP.</i>			
11.	Të punësuarit duhet të dërgohen në kontrole të detyrueshme shëndetësore në intervale të rregullta. Rregullore (MPMS) Nr.05/2017, Neni 15 <i>Kontrolli fillestar mjekësor i të punësuarve duhet të bëhet menjëherë pas punësimit. Kontrolli tjetër shëndetësor duhet të bëhet duke marrë parasysh rreziqet e agjentëve biologjikë, dhe duhet të ruhen shënimet.</i>			

12.	A është vënë në dispozicion mbikëqyrja mjekësore duke përfshirë vlerësimin e HBV, testimin e antitropave dhe vaksinimin për të punësuarit potencialisht të ekspozuar? Rregullore (MPMS) Nr.03/2017, Nenet 6.3, 6.4 * <i>Mbani shënime për mbikëqyrjen mjekësore dhe aktivitetet përkatëse (vaksinimi etj.).</i> * <i>Vaksinimi duhet të ofrohet falas për të gjithë të punësuarit dhe studentët që kryejnë veprimtari të kujdesit shëndetësor në vendin e punës.</i>			
13.	A e raportojnë menjëherë të punësuarit tek personi përgjegjës, dhe/ose te personi përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë, ndonjë incident ose aksident që ka të bëjë me mjete të mprehta? Rregullore (MPMS) Nr.03/2017, Neni 9 * <i>Mbani shënime për incidentet</i> * <i>Sigurohuni që ekzistojnë udhëzime se si dhe çfarë duhet të raportojnë të punësuarit dhe se ato respektohen.</i>			
14.	Sigurohuni që ka procedura që duhet të ndiqen nëse ndodh lëndimi me mjete të mprehta. Duhet të përshkruhen hapat e menjëhershëm për kujdesin ndaj të punësuarve të lënduar. Të punësuarit duhet t'i dinë dhe t'i ndjekin këta hapa. Rregullore (MPMS) Nr.03/2017, Neni 10			
PAS VETËVLERËSIMIT				
	* <i>Diskutoni me menaxhmentin e lartë për vëzhgimet dhe konkluzionet tuaja për përmirësimet e nevojshme.</i> * <i>Diskutoni me menaxherat e nivelit të mesëm të lokacionit/vendit të punës së vizituar për vëzhgimet dhe konkluzionet tuaja për përmirësimet e nevojshme.</i> * <i>Në rast se keni një ofrues të jashtëm të shërbimit të SSHP-së ose ekspert të SSHP-së, diskutoni me të për vëzhgimet dhe konkluzionet tuaja për përmirësimet e nevojshme.</i>			

	* Zbatoni masat e nevojshme të kontrollit të identifikuara gjatë vetëvlerësimit.			
--	--	--	--	--